




*Fletë pune 1.* Si i fitojnë paratë anëtarët e familjes tënde?

	Babai im punon në _____
	Nëna ime punon në _____
	Motra ime është studente/ nxënëse dhe punon /nuk punon _____
	Unë jam nxënës dhe para me japin prindërit e nganjëherë edhe _____
Vizato ndonjë anëtar tjetër të familjes tënde	Tregoni punën që e bën ai/ajo për të fituar para _____

**Fletë pune 2.** Disa punë të përditshme në shtëpi i bëni sepse jeni pjesë e familjes. Por nganjëherë mund të shpërbleheni me një shumë parash nga prindërit për punët shtesë rreth shtëpisë apo për punët që i bëni për t’i ndihmuar të tjerët? Shkruani poshtë figurës cilat janë punët që ju i konsideroni të përditshme dhe cilat punët shtesë.

 <p>I ndihmoj nënës për të larë enët</p> <p>Punë _____</p>	 <p>I ndihmoj babait për ta pastruar veturën</p> <p>Punë _____</p>	 <p>I ndihmoj gjyshit në vjeljen e pemëve</p> <p>Punë _____</p>
 <p>Mbledh gjethet e vyshkura</p> <p>Punë _____</p>	 <p>E rregulloj shtratin</p> <p>Punë _____</p>	 <p>I ndihmoj fqinjës së moshuar për të kryer blerjet</p> <p>Punë _____</p>
 <p>Shëtis qenin e fqinjës</p> <p>Punë _____</p>	 <p>Rregulloj lodrat</p> <p>Punë _____</p>	<p>Ndonjë punë tjetër që ti e bën?????</p>

Fletë pune 3. Lidh fjalitë me fotot përkatëse



Puna

Shpenzimet janë pagesat që ne i bëjmë për blerjet e gjësendeve dhe për të paguar shërbimet.



Shpenzimet

Kursimet janë paratë që ne i ndajmë sot për t'i përdorë me vonë.



Kursimet


Dhuratë /donacion janë një pjesë e parave nga kursimet tona të cilat i ndajmë me të tjerët.



Dhuratë/donacion

Puna është një detyrë të cilën duhet ta kryejmë për të fituar para.

**Fletë pune 4.** Ke fituar 95 Euro për ditëlindje. Dëshiron të bleh disa gjëra por gjithashtu dëshiron të kursesh 55 Euro për një video lojë për PS4 e cila del në treg muajin tjetër. Çfarë mund të bleh e çfarë jo nga gjërat e mëposhtme, pasi të kesh ndarë shumën të cilën doni ta kurseni?



Libri (5 Euro)



Akulllore (1 Euro)



Dy bileta për kinema për veten dhe motrën (6 euro)



Atlete të reja (40 euro)



Top futbollit, dhuratë për ditëlindjen e shokut (10 euro)



Një bluzë Nike (25 euro)



Picë (4 euro)




Lule për Ditën e mësueses (3 euro)



Waffle (2 Euro)

Fletë pune 5. E keni mbushur arkën e kursimeve dhe tash dëshironi që disa monedhat me vlerë më të vogël t'i këmbesh me një monedhë me vlerë më të madhe. Si do ta bëni këtë?



Fletë pune 6. Këmbeni bankënotat me vlerë më të vogël në bankënotë me vlerë më të madhe.



